



**Tea Zeqaj**

RAPORT MONITORIMI

QENDRESA  
QYTETARE



[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

Gusht-Tetor 2021

# KLIMA PO NDRYSHON! POLITIKA ?



## Klima po ndryshon, po politika në Shqipëri?



Tremujori i fundit përkoi me riformimin e qeverisë së re nga forca politike e përzgjedhur pas 25 prillit. Shtatori ishte një muaj i ngarkuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit teksa ministri Klosi u zëvendësua nga nga Zonja Mirela Kumbaro, të cilës i urojmë suksese në detyrën e re!

Me qeverinë e re dhe një ministër të ri në krye të institucionit vëmendja drejtohet te zbatimi i premtimeve të dhëna gjatë fushatës elektorale si dhe

përmirësimi i politikave mjedisore në tërësi.

Qartësisht, partitë politike nuk e kanë pasur mjedisin pjesë të premtimeve elektorale prej vitësh. Megjithatë, me valën e gjelbërt të politikave evropiane pritshmëritë për të pasur pjesë të vendimmarjes publike politika gjithmonë e më afër transformimit të gjelbër janë më të larta. Të tilla vendimmarrje, duke nisur nga legjislati deri tek vullneti për zbatimin e çdo akti, janë gjithashtu thelbësore për pranimin e Shqipërisë në Bashkimin e Evropian, por çështje më e rëndësishme për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe shëndetshëm të vendit.

Pavarësisht premtimeve që u dhanë dhe nuk u dhanë përpara zgjedhjeve, vendi ynë pati një forcë politike të përzgjedhur, e cila u rikonfirmua në krye të vendit për herë të tretë dhe prezantoi përpara qytetarëve që e zgjodhën një listë me prioritete ndër të cilat më poshtë listohen të sektorit të Turizmit:

- “Riorganizim i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, me ligj të ri të dedikuar. Menaxhimin e integruar të Bregdetit, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me Bashkitë bregdetare.
- Inkurajimi i brandeve të mirënjohura ndërkombëtare për të investuar apo operuar në Shqipëri.
- Përfundimi i procesit të lëvizjes së mjeteve lundruese përmes platformës online të hyrje-daljeve.
- Promovimi i Flamurit Shqiptar në tregun ndërkombëtar, si destinacion tax-free.
- Riorganizim i Agjencisë Kombëtare të Turizmit në përgjigje të flukseve të pritshmë turistike dhe të kërkesave në rritje të operatorëve turistikë”.

Ndërkohë që për sektorin e mjedisit prioritet si më poshtë:

- Menaxhim i integruar i mbetjeve në tërësinë e territorit sipas Masterplanit
- Reduktim me synim zhdukjen e ambalazhit plastik njëpërdorimësh

Përpara se të kalojmë në temën kryesore të këtij raporti, shkurtimisht më poshtë vërejtjet rreth prioriteteve të qeverisë në këtë mandat të tretë të deklaruar për mjedisin:

1. Mjedisi nuk është prioritet i qeverisë shqiptare. Tema e vetme e prioritarizuar është çështja e mbetjeve, duke lënë mënjanë të tjera çështje emergjente si mbrojtja e natyrës, ndotja e ajrit, ujit, tokës, ndryshimet klimatike, shpyllëzimi masiv, urbanizimi pa kriter, etj.
2. Plani i menaxhimit të integruar të mbetjeve, kësaj radhe më shumë se prioritet ndaj zgjidhjes përfundimtare të problematikës së mbetjeve, duket se do të japë prioritet financiar tre incineratorëve në Elbasan, Tiranë e Fier; si rrjedhojë jo trajtimit të mbetjeve sipas hierarkisë së rekomanduar nga Bashkimi Evropian (reduktim/ripërdorim/riciklim).
3. Zhdukja e ambalazhit plastik njëpërdorimësh është sa e thjeshtë aq edhe e pamundur. Reduktimi i ambalazhit plastik njëpërdorimësh në vetvete vjen përmes një fushate të mirë ndërgjegjësimiti. Në anëna tjetër, zhdukja e këtij ambalazhi është thujse e pamundur për aq kohë sa në Shqipëri mungon uji i pijshëm në çesma dhe qytetarët detyrohen masivisht të blejnë ujë dhe produkte të tjera jetike si qumështi në ambalazh plastike. Angazhimi dhe përmeshja e këtij objekti mbetet për tu parë në vijim.

## Ndryshimet Klimatike, një kërcënim real për Shqipërinë

Edhe pse në premtimet elektorale dhe në programin qeverisës, mjedisi nuk duket të jetë prioritet, qeveria ka nisur një fushatë aksionesh kryesisht pastrimi për të kthyer vëmendjen tek nevoja për një mjedis të pastër, sikur mbetjet të jenë i vetmi shqetësim real dhe zgjidhja përfundimtare e çdo problemi mjedisor.

E në fakt, të ndodhur ndosht në ditët e viti më të rëndësishme për mjedisin, në të gjithë botën vëmendja është drejtuar në nevojën emergjente për veprim ndaj Ndryshimeve Klimatike. Në fjalimin e mbajtur në Glasgow, në Samitin për Klimën COP-26, Kryeministri Rama u shpreh se vendi ynë nuk është një vend ndotës, përkundrazi, prodhon energji të gjelbër dhe pavarësisht kësaj vuan pasojat e

vendeve ndotëse. Si rrjedhojë, kërkoi ndihmën e vendeve të mëdha për mbështetjen e një vendi të vogël model si yni.

Dhe në fak cili është roli i Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike? Cilat janë zotimet



tona dhe në çfarë faze të përmbysjes së tyre jemi? A i kemi bërë mirë detyrat e shtëpisë dhe a i ka administrata jonë kapacitetet e nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrave?

Shqipëria është një nga vendet më të prekura në rajon prej ndryshimeve klimatike. Tendencat e ndryshimeve klimatike janë vënë re kryesisht gjatë 15 viteve të fundit me: rritjen e temperaturave, uljen e reshjeve dhe një shfaqje më të shpeshtë të fenomeneve ekstremeve të motit, si periudhat me thatësi dhe përmbytjet. Parashikimet e klimës, paralajmërojnë ulje të sasisë së reshjeve në stinën e verës me 10 % deri në 2020, dhe 20 % deri në vitin 2050.

Ndryshimet klimatike në Shqipëri u bënë më të theksuara gjatë dekadës së dytë 2010 -2020, dekadë e cila filloi me përmbytjet e Shqipërisë Veriore, ku banorët e u izoluan për gati 1 muaj nga ujërat që zaptuan qarqet Shkodër, Lezhë, Kurbin dhe pjesërisht Krujën. Zona të ndryshme urbane u përballën me përmbytje të izoluara nga viti në vit deri në shkurtin e vitit 2015 kur një tjetër përmbytje e përmasave masive rrezikoi jetën dhe pasurinë e banorëve nga Fieri deri poshtë në Gjirokastrë.



Një stuhi e natyrës tropikale përfshiu Shqipërinë nga Veriu në Jug duke regjistruar reshje mbi 200 milimetra në 24 orë, reshje këto më të larta se sasi të reshjeve mujore për shumicën e zonave perëndimore dhe jugore. Intensiteti i lartë i reshjeve në 2-3 ditë dhe prurjet e lumit Vjosa nga përtej kufirit e detyruan atë të dalë nga

shtrati dhe të vërshojë në të gjithë zonën jugore duke përmbytur shtëpi dhe rrëmbyer çfarë të gjente përpara. Është pikërisht kjo dekadë që përmban dhe 5-vjeçarin më të nxehtë në historinë e matjeve klimatike; vitet 2015 – 2019 janë vitet më të nxehta në historinë e matjeve, jo vetëm në Shqipëri dhe rajon, por edhe në të gjithë globin. Gjatë këtij 5-vjeçari, muajt e verës shënuan temperatura shumë të larta dhe spikat viti 2016, si viti me temperaturat më të larta, ku piku i nxehtësisë në qytete si Shkodra, Elbasani, Beratit dhe Gjirokastra kapërcyen temperaturën prej 43 gradëve.



# Rreziqet e Shqipërisë nga pasojat e Ndryshimeve Klimatike

## 1. Ndryshimi i motit

Dinamika e ndryshimit të reshjeve në Shqipëri është e pasigurt, por sipas studimeve shkencore më të fundit, vërehet një tendencë për ngrohjen e motit në të ardhmen: me dimër më të butë, verë dhe vjeshtë më të nxehtë dhe më të thatë. Parashikimi i klimës deri në vitin 2050 përfshin:

- Rritjen intensive të temperaturës (2.4 °C në 3.1 °C) nga muaji Qershor - Gusht.
- Zvogëlimin e sasisë së reshjeve vjetore (më pak se 10 %), me zvogëlim më të madh të sasisë në periudhën Qershor - Shtator.
- Rritje e sasisë së reshjeve të shiut, për shkak të zëvendësimit të reshjeve të borës me reshje shiu, duke zvogëluar potencialisht akumulimin sezonal të borës.
- Rritje të episodeve të stuhive me shi të dendur.
- Përmbytje përgjatë vijës bregdetare



Parashikimet klimatike në Shqipëri përfshijnë: rritje të temperaturës; mot më ekstrem me përmbytje, thatësira, valë të nxehti; dhe ndryshueshmëri të reshjeve shoqëruar me rënie të sasive mesatare në periudhën e verës.

## 2. Bujqësia

- Zhvillim i përshpejtuar i të korrave, shkurtrim i ciklit të rritjes
- Rritja e rendimentit për disa kultura (gruri); si dhe zvogëlimi i rendimentit për disa kultura të tjera, si misri ose zvogëlimi i foragjereve për bagëtinë, etj.
- Rritja e përmbajtjes së kripës dhe shkretëtirëzimi i tokës
- Rritja e ngordhjeve në bagëti dhe ulja e produktivitetit të tyre
- Rritja e ekspozimit ndaj dëmtueseve dhe sëmundjeve të reja



### 3. Burimet Ujore

- Ndryshimet ose pakësimi i prurjes së lumenjve, veçanërisht në stinën e verës.
- Ujërat nëntokësore pakësohen nga zvogëlimi i sasisë së ujërave sipërfaqësore dhe humbja e lagështirës së tokës.
- Devijime të modeleve të rënies së reshjeve: rënie e mundshme e sasisë në stinën e pranverës dhe rritje gjatë stinës së dimrit.
- Dëmtimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë, trajtimit të ujërave të zeza, të ujitjes dhe kullimit nga përmbytjet



### 4. Shëndeti i njeriut

- Rritja e vdekshmërisë nga i nxehti dhe përkeqësimi i kushteve ekzistuese
- Temperatura e larta ndikojnë në përqendrimin ose shpërndarjen e ndotësve të ajrit
- Rritja e gamës së sëmundjeve të transmetuara nga vektorët (p.sh., mushkonjat)

Qëndresa Qytetare i dërgoi Institutit të Shëndetit Publik një kërkesë për Informacion lidhur me pasojat e ndryshimeve Klimatike në shëndetin e qytetarëve në Shqipëri dhe si janë zhvilluar ato ndër vite. ISHP na dërgoi një studim të detajuar, ku ndër të tjera listohet se përgjatë viteve të fundit:

- 7.6% e fëmijëve kanë shfaqur diarre
- Niveli i të prekurve me astmë në vend është rritur
- Një në pesë fëmijë shfaq shenja të anemisë
- Një në 4 gra dhe më shumë se një në 3 burra ka hipertension
- Shkalla e vdekshmërisë totale (9% - 16%)

Analiza e ISHP dokumenton një relacion të fortë dhe të qendrueshëm midis rrezikut të gastroenteritit dhe temperaturave të verës gjatë periudhës së studimit 2016-2018. Nga ana tjeër ndikimi i përmbytjeve masive në qarkullimin e brejtësve shpjegon kulmin e rasteve të leprospirozave. Të tjera trende rritëse parashikohen sëmundje kardiovaskulare, goditje në tru, insuficiencia e zemrës, hipertension, etj ku rajoni më i prekur pritet të jetë Baseni i Vjosës.<sup>1</sup>



<sup>1</sup> ISHP: Ndikimi i kushteve klimatike në shëndet dhe kapacitetet ekzistuese

## 5. Zonat bregdetare

- Dëmtimi i infrastrukturës bregdetare, përfshin objektet e turizmit dhe tokën bujqësore
- Ndryshime në ekosistemet lagunore, ligatinave dhe brezit pyjor bregdetar
- Rritja e kripësisë së akuaferëve bregdetarë të ujërave të ëmbla
- Rritja të përmbytjeve në bregdet deri në vitin 2100



## 6. Energjia dhe Infrastruktura



- Zvogëlim i potencialit të hidrocentraleve
- Ndryshim të kërkesës sezonale për ngrohje dhe ftohje
- Konkurrencë për burimet ujore midis sektorëve të hidroenergjisë dhe bujqësisë (ujitjes)
- Zvogëlim i efikasitetit të linjave të transmetimit dhe shpërndarjes, për shkak të rritjes së temperaturës
- Dëme në infrastrukturë shkaktuar nga përmbytjet


## 7. Ekosistemet

- Rrezik i shtuar i zjarreve në pyje
- Zhvendosja e habitatit, humbja dhe copëzimi i habitateve, duke cenuar mbijetesën e llojeve dhe prishur modelet e migrimit të llojeve
- Zvogëlimi i sasisë së ujit të ëmbël, duke kërcënuar zonat ligatinore.

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO), si i vetmi i këtij dimensionit në vend, i cili monitoron treguesit që lidhen me ndryshimet klimatike, pranon se "Temperatura mesatare vjetore është rritur, sidomos në 10 vitet e fundit. E njëjta gjë vërehet edhe te temperaturat minimale dhe maksimale vjetore që kanë tendencë rritje."

- Sipas Bankës Botërore vendi ka përjetuar një rritje të temperaturës mesatare vjetore prej 1 °C që nga vitet 1960





Vera që sapo kaloi që një nga më të vështirat që vendi ynë ka kaluar si pasojë e vatrave të zjarrit të cilat u shtrinë pothuajse në të gjithë territorin e vendit. Intensiteti u shtua sidomos pas datës 25 korrik 2021 kur edhe u shënuan temperaturat më të larta prej vitesh. Temperaturat e larta dhe valët e të nxehtit kanë shërbyer si aplifikues i zjarreve ndër vite.



Si një kërcënimet kryesore të ndryshimeve klimatike, shtetet duhet të jenë të përgatitura për atë që quhet përshtatje, duke planifikuar në fondin për emergjencat civile kapacitete materiale dhe njerëzore në përballimin e të tilla katastrofave.

Sipas AKMC, bashkitë më të prekura këtë verë ishin: Shkodra, Fieri, Vlora, Durrësi, Gjirokastra, Lezha, Dibra, Korça, Berati, Kukësi, Tirana dhe Elbasani. Zjarret janë

përhapur nga veriu në jug duke përfshirë pyje, kullota dhe prona private. Si pasojë e temperaturave të larta, përhapja e zjarreve ka rrezikuar jetë njerëzish, banesa, gjënë e gjallë, trashëgimi kulturore, zona pyjore dhe parqe arkeologjike.<sup>2</sup>

Si rezultat i vatrave masive që përfshinë vendin gjatë periudhës korrik-gusht u dëmtuan 33,420 hektarë kullota, pyje e shkurre si dhe mbi 14.234 mijë rrënjë ullinj e pemëtari.<sup>3</sup>

Kapacitetet e vendit për përballimin e situatës kanë qenë modeste, prandaj dhe autoritetet shqiptare kanë marrë ndihma nga BE për normalizimin e gjendjes.

Në këto operacione janë angazhuar rreth 4960 efektivë të Forcave të Armatosura, rreth 152 mjete të Forcave të Armatosura, rreth 3309 forca policore, rreth 1914 forca zjarrfikëse, mbi 370 mjete të MZSH, 20 ambulanca, mbi 1.000 punonjës bashkiakë, mbi 606 forcat e Shërbimit Pyjor dhe e gjithë administrata e Mbrojtjes dhe 1400 forca vullnetare. Ndërhyrja nga ajri u krye përmes ekuipazheve të 7 helikopterëve të Shqipërisë, Holandës dhe Çekisë. Një ndihmë në punën për shuarjen e zjarreve ishte

<sup>2</sup> Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)

<sup>3</sup> <https://www.mod.gov.al/index.php/neesroom-2/5115-menaxhimi-i-zjarreve-rama-e-peleshi-vleresojne-punen-e-forcave-te-angazhuara-dhe-mbrojtjes-civile>





edhe mbështetja me pajisje nga SHBA.<sup>4</sup>


Kosova gjithashtu në datë 9 gusht dërgoi trupa nga Forca e Sigurisë së Kosovës të cilët dhanë kontribut në menaxhimin e zjarreve në malin e Shemrisë, në zonën e tunelit të Kalimashit. Çekia dhe Holanda kanë sjellë 3 aeroplanë për shuarjen e zjarrit, ndihmë nga Mekanizmi i Mbrojtjes Civile nga Bashkimi Evropian.

Ky ishte bilanci dhe fuqia njerëzore e motorike e operacioneve nga toka dhe ajri, për të luftuar me 389 vatra të zjarrit në të gjithë vendit në harkun e dy muajve.<sup>5</sup>

Ajo që u diskutua gjerësisht në publik ishte mungesa e dukshme e kapaciteteve materiale dhe njerëzore, si dhe pyetjet që u ngritën ishin a do të mundeshim ta shmangnim përhapjen e zjarreve në të tilla përmasa nëse do të ishim përgatitur mjaftueshëm parapakisht?

Burimi: Banka Botërore

MESATARJA VJETORE E DUKURIVË TË FATKEQËSIVË NATYRORE 1900-2018, SHQIPËRIA



Përveç sektorëve të mësipërm, të tjerë sektorë të rëndësishëm të cilët po preken nga Ndryshimet Klimatike janë edhe turizmi, industria e verës, industria e pijeve, industrinë e ndryshme ushqimore, etj. Pra një ndikim i drejtpërdrejtë në tavolinat tona.

## Ndryshimet Klimatike në premtimet elektorale të Partive Politike

Duke konsideruar emergjencën e krizës klimatike, qytetarët, organizatat joqeveritare si dhe trupat ndërkombëtarë i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë monitorimit të premtimeve elektorale të secilës parti në garë lidhur me ndryshimet klimatike dhe vlerësimin e riskut. Milieukontakt Shqipëri një organizatë jofitimprurëse mjedisore, me suportin e Ëestminster Foundation for Democracy, lançoi vetëm pak ditë më parë Regjistrin e Premtimeve Elektorale<sup>6</sup> Në këtë regjistër listohen në mënyrë të specifikuar fushat që lidhën me mjedisin dhe për secilën prej tyre premtimet në program dhe ato të shprehura nëpër daljet publike. Monitorimi i premtimeve elektorale të partive politike lidhur me mjedisin është bërë gjithashtu nga Qendresa Qytetare fill para zgjedhjeve të 25 prillit. Vlen të theksohet se këto lloj monitorimesh

<sup>4</sup> Media: Balkan web <https://www.balkanweb.com/zjarret-ne-vend-peleshi-ben-bilancet-mbi-3-mije-ha-toke-eshte-djegur-do-te-modernizojme-mbrojtjen-civile-bashkite-te/>

<sup>5</sup> Ministria e Mbrojtjes <https://www.mod.gov.al/index.php/newsroom>

<sup>6</sup> [https://milieucontact.org/regjistri-i-premtimeve-elektorale/?fbclid=IëAR2ufFHAbo2-fLxZ\\_M09sO9JTJDsscRp8skFëitSFMucyLNa\\_k8LmVe-RDg](https://milieucontact.org/regjistri-i-premtimeve-elektorale/?fbclid=IëAR2ufFHAbo2-fLxZ_M09sO9JTJDsscRp8skFëitSFMucyLNa_k8LmVe-RDg)

janë shumë të rëndësishme për të dhënë pasqyrën e prioriteteve që qeveria e ardhshme do të ketë për vendin, vëndosur përballë prioriteteve reale apo të perceptuara nga qytetarët.

Në këtë raport do të ndalemi për të shkëputur nga regjistri vetëm premtimet që lidhen me ndryshimet klimatike si më poshtë.

Fusha e mjedisit	Partia Politike	Programi	Premtimet
<b>Ndryshimet klimatike/vlerësimi i riskut</b>	PD	Për Ndryshimet Klimatike do të punohet me: Plan Kombëtarë për zbatimin e Axhendës së Gjelbër; Plan Kombëtar për pyjet dhe kullotat; Plani Kombëtar për Sistemin e Monitorimit Mjedisor; Plani Kombëtarë për Ndryshimet Klimatike Rishikim dhe përfshirje të Vlerësimi të Ndikimit Strategjik në Planet Kombëtare dhe Zhvillimit të Territorit <sup>7</sup>	Zgjidhja e problemeve të përmytjeve të qyteteve tona dhe përfundimin me shpejtësi i riparimit dhe rehabilitimit të të gjitha dëmeve të tërmetit. <sup>8</sup>
<b>Ndryshimet klimatike/vlerësimi i riskut</b>	PS	S'ka program	S'ka premtime
<b>Ndryshimet klimatike/vlerësimi i riskut</b>	PDIU	Ne do të mbështesim programet e fermerëve, që i aftësojnë ata për të menaxhuar rrezikun e jashtëzakonshëm që hasin çdo vit në fusha. Këto programe duhet të shërbejnë si mjete me kosto efektive të menaxhimit të rrezikut, duke ofruar alternativa që përmirësojnë aftësinë e prodhuesve për të vepruar në kohë të vështira. Suksesi i sistemit tonë të politikave të menaxhimit të riskut do t'iu mundësojë fermerëve të vazhdojnë të ushqehen, të furnizojnë kombin dhe të eksportojnë. <sup>9</sup>	S'ka premtime
<b>Ndryshimet klimatike/vlerësimi i riskut</b>	LSI	S'ka Program	S'ka premtime

Regjistri është kujdesur të vendosë përballë edhe premtimet elektorale për legjislaturën 2017-2021 dhe rezultatet nuk ishin shumë larg atyre që mund të shihen në tabelën e mësipërme. Pra, dukshëm një neglizhim i mjedisit dhe në veçanti

<sup>7</sup> Burimi: Recognition of ENVIRONMENT and CLIMATE by Right-Wing Political Parties' Programmes in Western Balkan - May 2021

<sup>8</sup> <https://pd.al/2021/02/basha-ulje-e-cmimit-te-energji-se-per-familjet-dhe-bizneset/>

<sup>9</sup> <https://www.prsh.al/programi/programi/>

çështjes së ndryshimeve klimatike në vend. Kjo temë mungon e reflektuar në programe politike, po aq sa mungon në debatin publik të politikëbërësve. Ashtu siçvërehet edhe në tabëlën e bërë publike për qytetarët nga Miliekontakt, vetëm dy parti politike kanë artikuluar angazhimin për veprim ndaj ndryshimeve klimatike, teksa partitë e tjera kryesore në vend e kanë injoruar këtë temë.

Nëse dhe sesa këto premtime janë reflektuar në vota dhe mbështetje nga qytetarët është e vështirë për tu gjykuar, e megjithatë kjo nuk pengon monitorimin dhe kritikën publike për vëmendjen e munguar ndaj ndryshimeve klimatike.

## Kuadri Ligjor


Në vitin 1995, Shqipëria ratifikoi Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Në vitin 1998, Ministria e Mjedisit, përgjegjëse për aspektet klimatike, krijoi Departamentin e Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike për të adresuar problematikën përkatëse, në koordinim me UNDP. Pas riorganizimit të ministrisë në 2017, departamenti i dedikuar çështjes së ndryshimeve klimatike brenda ministrisë u shpërbë.

Në dhjetor të vitit 2004, qeveria ratifikoi Protokollin e Kiotos që synonte reduktimin ose kufizimin e emetimeve të gazrave të efektit serrë (GES) për vendet e Evropës Lindore me 24% nga viti bazë deri në vitin 2010 (Heyhoe, et al., 1998). Për të arritur objektivin e Konventës, u hartuan një sërë masash të cilat kanë të bëjnë me: rritjen e efikasitetit të energjisë; gjetjen, zhvillimin dhe përdorimin e formave të reja të shfrytëzimit të energjisë së rinovueshme; përdorimin e teknologjive inovative në aspektin mjedisor për eliminimin e dioksidit të karbonit. Që nga ratifikimi i Marrëveshjes së Parisit 2015 në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara në Konferenca e Palëve për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) 21, shumica e qeverive kombëtare kanë miratuar masat për të ulur emetimin e gazrave serrë (GES) në atmosferë, gjë që ka një ndikim mbi modelet industriale të secilit vend. Ky angazhim reflekton një model të ri të qeverisjes ndërkombëtare që synon të balancojë ambicien, llogaridhënien dhe transparencën në angazhimet e marra në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe të saktë, duke pasur si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm.

Sot qeveria shqiptare ka një Strategji për Ndryshimet Kimatike dhe Plani i veprimit 2020-2030, si dhe prej dhjetorit 2020 ka kaluar në kuvend Ligji për Ndryshimet Klimatike pas më shumë se 3 vitesh që priste sirtareve të burokratëve.

E megjithatë aktiviteti i legjislacionit për klimën në Shqipëri duket të jetë i ngadaltë dhe i paplotë.





Grafiku: Ligjet dhe vendimet për klimën, krahas legjislacionit për gjithë sektorët në tërësi, miratuar në 2021.

Aktet për klimën zënë një përqindje thuajse të papërfillshme, në raport me zhvillimet ligjore të miratuara nga Kuvendi dhe Qeveria në bazë viti. E shprehur në përqindje, pjesa që zënë zhvillimet ligjore për klimën në raport me tërësinë e ligjeve dhe akteve të miratuara shkon nga 0.001% në 2019 në 0.003 % në 2021. Ky tregues rezulton më i

lartë në përqindje, për shkak se numri i ligjeve dhe akteve të miratuara në 2021, që është vit i paplotë, është më i vogël.

Raportet e KE për vitet 2020-2021 paraqesin një tendencë përmirësuese të vlerësimit për vendin që citon: "Shqipëria ka arritur një lloj progresi për sa i përket adresimit të ndryshimeve klimatike, por harmonizimi i legjislacionit të vendit me kuadrin evropian është ende i kufizuar"<sup>10</sup>. Megjithatë, Raporti i Progresit për 2020, njeh në mënyrë të shprehur miratimin e Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike për 2019-2030, me objektiva për 2050. Të gjithë raportet përmendin sfidat e mëdha përpara Shqipërisë, gjatë procesit të negociatave me BE-në dhe anëtarësimit, për shkak të objektivave të rinj të klimës vendosur nga BE. "Mungesa e strukturave të caktuara dhe personelit të nevojshëm për t'u marrë me ndryshimet klimatike është një çështje mjaft shqetësuese"<sup>11</sup>.

Raporti i KE, 2021: "Shqipëria ka arritur njëfarë progresi në këtë fushë. Ka progres të vogël, për sa i përket përafrimit të mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit kuadr të BE-së, për sektorë si menaxhimi i ujërave, kimikatet, krimi mjedisor dhe mbrojtja civile. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin dhe fuqizimin, veçanërisht lidhur me menaxhimin e ujërave, cilësisë së ajrit dhe ndryshimet klimatike."

## Kuadri Institucional

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** përmes Njesisë për Ndryshimet Klimatike, është pika qendrore në nivel kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadr të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK). Njësia bashkëpunon me një ekip teknik ndërdisiplinor dhe ndërinstucional për të përmbushur detyrat e Shqipërisë si anëtare e KKKBNK8 . **Inspektorati Shtetëror i Mjedisit** identifikon dhe u përgjigjet çështjeve që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Përgjegjësitë e **Agjencisë**

<sup>10</sup>[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)


<sup>11</sup>[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-%2010/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-%2010/albania_report_2020.pdf)

**Kombëtare të Mjedisit** përfshijnë lejjimin, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe informacionin publik. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** është përgjegjëse për politikën kombëtare të klimës dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për ndryshimet klimatike në këndvështrimin e efikasitetit të energjisë dhe energjitë e rinovueshme në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i strukturës së dy institucioneve nga QBM është vënë re se MTM nuk ka të përfshirë në strukturë, sektor përgjegjës për klimën. Pranë kësaj ministrie ekziston një njësi përgjegjëse për klimën nën sektorin e politikave mjedisore. Në MIE struktura përgjegjëse për klimën është e shprehur si sektor i veçantë për energjitë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, kuadri i punës i së cilës është i fokusuar tek projektet dhe investimet në këtë fushë. Në përgjithësi numri i personave të punësuar në këto njësi është i vogël. Në disa raste 2-3 persona, që vlerësohet se është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kapacitetet e nevojshme për të adresuar nevojat për klimën në secilin institucion. Agjencitë në nivel qendror që kontribuojnë në çështjet e klimës janë Agjencia e Efikasitetit të Energjisë (AEE) dhe në mënyrë të tërthortë AKM, AKBN, AMBU, AKP AMB, etj.. AEE që është krijuar në 2016 dhe ka si objektiv "përmirësimin dhe promovimin e efikasitetit të energjisë gjatë gjithë ciklit të energjisë në të gjithë sektorët dhe zonat ekonomike të vendit, për të mundësuar konsumatorët të ulin kostot e furnizimit me energji dhe të zvogëlojnë ndikimet negative të ndotjes në mjedis dhe ndryshimet klimatike, asnjë nga agjencitë e tjera nuk ka një sektor të mirëfilltë përgjegjës për klimën. AKM është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave lidhur me ndotjen, por pa arritur ende të diferencojnë ndotësit që lidhen vetëm me klimën. Ndërkohë agjencitë e tjera i trajtojnë çështjet e klimës kryesisht vetëm si adresim i pasojave që rrjedhin prej saj.

Edhe Komisioni Evropian ka vënë re një mungesë kapacitetesh institucionale për sektorin të cilat i ka reflektuar në raportin e vitit 2021, i cili cilëson "Nevojitet një rishikim i shpejtë i strategjisë, tashmë të vjetër dhe i planit kombëtar të veprimit, në kontekstin e planeve vendore dhe nivel prefektore, të emergjencës. Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemi i paralojmërimit të hershëm nuk janë ende në lartësinë e duhur".

Grafiku 3: Veprimtaritë për klimën organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, sipas viteve



### Buxhetimi i Sektorit të Ndryshimeve Klimatike

Qendra Burimore Mjedisore (REC Albania) me mbështetjen e Ëestminster Foundation for Democracy ka publikuar një raport monitrimi për Strategjinë e Ndryshimeve Klimatike, kur ndër të tjera ka analizuar buxhetimin e ndryshimeve klimatike dhe sektorëve të tjerë të mjedisit.

Grafiku 1: Boshllëku financiar i shpenzimeve për klimën x 7 më i vogël ('000 Lekë)



Grafiku, paraqet totalin e financimeve publike (shtylla blu), që janë njohur si të lidhura me klimën për tre vite (2019-2021), përkundër nevojave të vendit që cilëson dokumenti i strategjisë (tabela 9), për të njëjtën periudhë kohe. Nga ballafaqimi i realizimit për klimën gjatë viteve 2019-2021 dhe nevojës së cilësuar në strategji (tabela 9) për të njëjtën periudhë, boshllëku është 47,933,848 (000 leke) ose 7 herë më i madh se realizimi trevjeçar. Kjo tregon se analiza financiare e strategjisë, ose nuk ka qenë realiste, ose e pabazuar në

angazhimin financiar buxhetor dhe financimet e huaja.

### Projektet e Ndhmës së Huaj për projekte të lidhura me klimën 2019-2021

Projektet e Ndhmës së Huaj për projekte të lidhura me klimën 2019-2021			
	Shuma (mln EUR)	Nr. i Projekteve	Kohëzgjatja
<b>Ndihma e Huaj</b>	<b>257.80</b>	<b>13</b>	<b>Shumëvjeçare (1 deri në 5)</b>

Ndërkohë që numri i projekteve të ndihmës së huaj, miratuar nga Qeveria e Shqipërisë gjatë periudhës 2019-2021 përfshin 13 projekte në total, kundrejt një shumë rreth 257.8 M EUR. Vlen të theksohet se projektet janë angazhim disa-vjeçar, zbatimi i të cilave përgjithësisht merr më tepër kohë se afatet e përcaktuara në VKM. Fatkeqësisht, nuk ka një instrument që të evidentojë shumën e shpenzuar ose të disbursuar në aktivitete me ndikim të mundshëm në mbrojtjen e mjedisit.

## Gjetjet kryesore

Ndryshimet klimatike nuk janë pjesë e prioriteteve të listuara të Qeverisë Shqiptare për mandatin e tretë qeverisës. Politikëbërësit e shohin vendin tonë si jo kontribues dhe përtej kësaj përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nuk ka vëmendjen e duhur në nivel qendror dhe lokal. Pjesa që zënë zhvillimet ligjore për klimën në raport me tërësinë e ligjeve dhe akteve të miratuara shkon në 0.003 % në 2021, masë e pamjaftueshme për rëndësinë e sektorit.

Shqipëria është një nga vendet më të prekura nga ndryshimet klimatike në Evropë. Pasojat ndihen në sektorë të ndryshëm të ekonomisë (bujqësia, turizmi, etj), katastrofat natyrore kanë prekur drejtpërdrejt shtëpitë dhe bizneset tona, valët e të nxehtit dhe përmbytjet kanë ndikuar në ekosisteme si dhe në shëndetin e njerëzve duke shkaktuar trende rritëse të një sërë sëmundjesh dhe vdekshmërisë totale në vend.

Ndryshimet klimatike nuk ishin pjesë e premtimeve elektorale të partive politike në vend për zgjedhjet e 25 prill 2021. Të vetmet parti që patën një paragraf modest lidhur me këtë çështje ishin PD dhe PDIU, të cilat nuk arritën të vinin në pushtet.

Administrata shtetërore, e cila merret me sektorin e Ndryshimeve Klimatike ka një mungesë të theksuar kapacitetesh njerëzore: 2-3 persona, që vlerësohet se është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kapacitetet e nevojshme për të adresuar nevojat për klimën në secilin institucion. Komisioni Evropian gjithashtu është shprehur se : "Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemi i paralajmërimit të hershëm nuk janë ende në lartësinë e duhur".

Në një ballafaqim të totalit të financimeve publike, që janë njohur si të lidhura me klimën për tre vite (2019-2021), përkundër nevojave të vendit që cilëson dokumenti i strategjisë, për të njëjtën periudhë kohe vihet re një bollshëk prej 47,933,848 (000 leke) ose 7 herë më i madh se realizimi trevjeçar. Kjo tregon se analiza financiare e strategjisë, ose nuk ka qenë realiste, ose e pabazuar në angazhimin financiar buxhetor dhe financimet e huaja.

## Rekomandimet

Nevojitet një vëmendje reale e shtuar ndaj sektorit të ndryshimeve klimatike, njohja e tyre dhe punë intensive në nivel qendror dhe lokal për zbutjen dhe përshtatjen. Aktet nënligjore të ligjit për ndryshimet klimatike duhet të plotësohen dhe zhvillohen më tej për të arritur impaktin real të kërkuar.

Emergjencat civile duhet të përgatiten në kapacitete njerzore dhe materiale për të gjitha pasojat e mundshme të ndryshimeve klimatike për të mbrojtur kështu jetët e njerëzve dhe të gjitha specieve me të cialt bashkëjetojmë, shtëpitë, tokat dhe bizneset tona. Një mungesë kapacitetesh si ajo që dëshmuam verën e vitin 2021 është e patolerueshme.

Nevojë emergjente në rritjen e stafit dhe forcimin e kapaciteteve të tyre individuale dhe institucionale për të punuar në një sektor shumë të rëndësishëm siç është ai i ndryshimeve klimatike. Rekomandohet rihapja e një drejtorie të dedikuar Ndryshimeve Klimatike nën varësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Qendra Burimore e Mjedisit për buxhetimin e projekteve lidhur me ndryshimet klimatike nga fondi publik, rekomandohet një rishikim dhe rregullim i buxhetimit të Strategjisë për Ndryshimet Klimatike në mënyrë të tillë që ky buxhet të mund të monitorohet për të siguruar materializimin e tij.





# #QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.